

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: UNIVERSITETI UKSHIN HOTI

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: 208/91900-25-10811-2-1-1

Sa i përket tenderit për **Ofrimi i shërbimeve të pastrimit dhe mirëmbajtjes së objekteve të Universitetit**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

Schafberger jr. Gmbh & Erik Shpk
(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Nena Tereze
(Adresa)

Glllogoc 13000
(Vendi) (Kodi postar)

045/293398
(Numri Telefonit) (Numri i Faks-it)

Blerina Kurtishaj
(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)
schafbergerkosove@gmail.com
(Adresa elektronike)

10.09.2026
(Data e parashtrimit të ankesës)


(Nënshkrimi dhe vula)

*Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit)

(Numri i faks-it)

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të ankesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “ Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës”, “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

Njoftimi per kontrate dt.-----27.11.2025
Procevrballi i hapjes se tenderit---30.01.2026
Njoftimi per vendimin e AK dhe Letrat Standarte dt-----13.02.2026
Kërkesë për Rishqyrtim dt.-----18.02.2026
Vendim i Refuzimit te Kerkese per Rishqyrtim-----19.02.2026
Ankesa ne Oshp me dt.-----28.02.2026
Vendimi i OSHP-se-----06.05.2026
Vendimi i AK-----29.05.2026
Kerkesa per Rishqyrtim-----03.06.2026
Vendimi i Refuzimit te Kerkeses per Rishqyrtim---03.06.2026
Ankesa Oshp-----12.06.2026
Vendimi i Oshp-se -----11.08.2026
Kerkesa per dokumentacion ATK,GJE-----20.08.2026
Derfimi i dokumenteve ATK-GJE-----21.0802026
Vendimi i AK-----24-08.2026
Kerkesa per Rishqyrtim-----28.08.2026
Vendimi i Refuzimit te Kerkeses per Rishqyrtim---02.09.2026

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐

Jo ☒

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☒

Jo ☐

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po ☒

Jo ☐

Sipas Legjislacionit ne fuqi per Prokurim Publik mbrenda afatit ligjor kemi parashtruar Kërkesë për Rishqyrtim pran Autoritetit Kontraktues Universitetit Ukshin Hoti me dt.28.08.2026.

Vendimin mbi refuzimin e kesja Kerkese eshte publikuar me dt.02.09.2026

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Sipas dispozitave ligjore të Lpp-së, përkatësisht nenit 108A dhe afateve ligjore te paragrafit 3.2 në bazë të së drejtës sonë paraqesim kërkesë për ri-shqyrtim baza ligjore:

Ligji Nr. 04/L-042 Për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Lgjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092 (Versioni i Konsoliduar)

Dispozitat e shkeluara të Lpp-së

Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo-Diskriminimi, par. 1, 2, 3, 4

Neni 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahassimi i Tenderëve, par. 2 dhe 4

Neni 60 Kriteret për Dhënien e Kontratës, par. 1, 1.1

Neni 52 Njoftimi i kriterëve për dhënien e kontratës par.

Neni 25 i Versionit te konsoliduar re rregullores 001/2022 paragrafi 25.9 dhe 25.10

Neni 108/A Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve par.10.2

Interpretime ne KRPP

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthejë tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë të rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuara për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Pas Pranimit të vendimit për refuzimin e kërkesës për Rishqyrtim, të paknaqur me këtë vendim paraqesim ankesën me të njëjta pretendime.

Pas Vendimit të OSHP-së nr. 2026/0379, Autoriteti Kontraktues, edhe pse ne të gjitha pikat e ankesës sone janë kthyer si të bazuar, nuk e ka zbatuar në tërësi vendimin dhe rekomandimet e dhëna nga OSHP-ja.

Duke e mbështetur në tërësi ankesën tonë, OSHP-ja ka konstatuar se Grupi i Operatorëve Ekonomikë që ne përfaqësojmë ka paraqitur ofertën më të lirë dhe të përgjegjshme, në përputhje me Ligjin për Prokurimin Publik, kriteret për dhënien e kontratës dhe të gjitha kërkesat e përcaktuara në Dosjen e Tenderit.

Konsiderojmë se gjatë procesit të rivlerësimit dhe vlerësimit të ofertave janë shkelur dispozitat e legjislacionit në fuqi, si dhe kërkesat e dokumenteve të tenderit, duke na shkaktuar dëm material dhe duke cenuar parimet e trajtimit të barabartë, transparencës dhe konkurrencës së drejtë në këtë procedurë prokurimi.

Për rrjedhojë, pretendimet tona ankimore mbeten në fuqi dhe paraqiten si më poshtë:

Ndaj vendimit të Autoritetit Kontraktues me të cilin Grupi ynë Ekonomik është shpallur i papërgjegjshëm dhe është eliminuar nga procedura e prokurimit, si dhe ndaj veprimit të mëtejshëm të Autoritetit Kontraktues për shpalljen e një operatori tjetër ekonomik/grupi ekonomik fitues.

Konsiderojmë se vendimi i kundërshtuar është i kundërligjshëm, i pabazuar në gjendjen faktike dhe juridike, si dhe në kundërshtim me vendimin/urdhëresën e mëparshme të Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), për arsyet e paraqitura më poshtë.

I. MOSZBATIMI I VENDIMIT DHE URDHËRESËS SË OShP-së

Në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit, OShP-ja ka nxjerrë vendim/urdhëresë me të cilën ka obliguar Autoritetin Kontraktues që të veprojë në përputhje me konstatimet dhe udhëzimet e dhëna nga OShP-ja, përkatësisht të anulojë vendimin e mëparshëm dhe të zbatojë vendimet paraprake të OShP-së.

Pas pranimit të kësaj urdhërese, Autoriteti Kontraktues na ka kërkuar dokumentacion shtesë, përfshirë vërtetimet nga Administrata Tatimore e Kosovës (ATK) dhe vërtetimet përkatëse nga gjykata, me qëllim të përfundimit të procedurës dhe shpalljes së operatorit fitues.

Ne kemi vepruar në mënyrë të plotë dhe brenda afatit të përcaktuar nga Autoriteti Kontraktues, duke dorëzuar dokumentacionin e kërkuar për të dy anëtarët e Grupit të Operatorëve Ekonomikë.

Për rrjedhojë, Autoriteti Kontraktues kishte për detyrë që të analizonte dokumentacionin e dorëzuar në mënyrë objektive, të plotë dhe në përputhje me urdhëresën e OShP-së, dhe jo të krijonte një bazë të re për eliminimin e Grupit tonë Ekonomik duke u bazuar në një interpretim të gabuar të gjendjes tatimore.

Vendimi i OShP-së është detyrues për Autoritetin Kontraktues dhe zbatimi i tij duhet të bëhet në përputhje me përmbajtjen dhe qëllimin e tij. Autoriteti Kontraktues nuk mund të anashkalojë efektin juridik të një vendimi të OShP-së duke e rivlerësuar çështjen mbi të njëjtat rrethana, pa ekzistuar një bazë e re, konkrete dhe ligjërish të qëndrueshme.

Arsyetimi I AK në Refuzimin e Kërkesës për rishqyrtim ndër të tjera thotë: “Asnjë vendim i OShP-së i nxjerrë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit nuk e ka shpallur GOE- Schafberger jr. GmbH & Erik Shpk në fitues dhe as nuk e ka obliguar Autoritetin Kontraktues që t’ia japë kontratën këtij grupi.”

Ky arsyetim i AK-së paraqet një interpretim të ngushtë dhe të pasaktë të rolit dhe efektit të vendimeve të OShP-së. Është e vërtetë se OShP-ja nuk e shpall drejtpërdrejt një operator ekonomik fitues dhe, si rregull, nuk zëvendëson Autoritetin Kontraktues në marrjen e vendimit për dhënie të kontratës. Megjithatë, OShP-ja shqyrton ligshmërinë e veprimeve dhe vendimeve të AK-së, përfshirë arsyet e eliminimit të operatorëve ekonomikë, duke i analizuar pretendimet, faktet dhe provat e paraqitura nga palët.

Në këtë kuptim, fakti që OShP-ja nuk e ka përdorur shprehimisht termin “shpallet fitues” nuk mund të interpretohet si mundësi për AK-në që, pas rivlerësimit, të krijojë apo të përdorë një bazë të re për eliminim. Përkundrazi, pas zbatimit të vendimit të OShP-së, AK ka qenë i obliguar të bëjë rivlerësimin në përputhje me konstatimet dhe udhëzimet e dhëna nga OShP-ja, si dhe me LPP-në dhe Dosjen e Tenderit.

Për më tepër, në rastin konkret, nga rivlerësimi rezulton se GOE-ja jonë plotëson kërkesat e përcaktuara në Dosjen e Tenderit dhe se oferta jonë është oferta me çmimin më të ulët. Rrjedhimisht, pasi arsyet e mëparshme të eliminimit janë konstatuar të pabazuara dhe nuk ekziston një bazë tjetër e ligjshme për eliminim, rezultati i procesit të rivlerësimit duhet të jetë vlerësimi i GOE-së si ofertues i përgjegjshëm dhe vijimi i procedurës drejt

rekomandimit për dhënie të kontratës, në pajtim me kriteret e përcaktuara në Dosjen e Tenderit dhe dispozitat e LPP-së.

Prandaj, konsiderojmë se arsyetimi i AK-së është jo vetëm i pasaktë në interpretimin e efektit të vendimit të OShP-së, por edhe i pamjaftueshëm për të justifikuar eliminimin e GOE-së, pasi nuk sqaron në mënyrë të argumentuar bazën ligjore mbi të cilën është mbështetur ky eliminim i ri.

II. INTERPRETIMI I GABUAR I GJENDJES TATIMORE TË ANËTARIT TË GRUPIT

Një nga arsytet kryesore të përdorura nga Autoriteti Kontraktues për eliminimin e Grupit tonë Ekonomik ka qenë fakti se njëri nga anëtarët e grupit, **SCHAFBERGER JR. GmbH – Dega në Kosovë**, ka pasur detyrime ndaj Administratës Tatimore të Kosovës dhe se marrëveshja me ATK-në për shlyerjen e këtyre detyrimeve është lidhur më datë **27.03.2026**, ndërsa Njoftimi për Kontratë është publikuar më datë **27.11.2025**.

Ky arsyetim nuk qëndron juridikisht dhe faktikisht.

Autoriteti Kontraktues ka marrë si pikënisje vetëm datën formale të marrëveshjes së fundit me ATK-në, pa e analizuar në tërësi marrëdhënien dhe pa komunikuar me operatorin ekonomik pasi neve na eshte thene se AK pret nje interpretim nga KRPP per keto dokumente.

Në veçanti, theksojmë se operatori ekonomik, edhe para datës 27.11.2025, përkatësisht para publikimit të Njoftimit për Kontratë, ka qenë në marrëveshje me Administratën Tatimore të Kosovës.

Kete e kemi dokumentuar me deklaraten te cilen e kemi derguar te Autoriteti Kontrakteus pasi Autoriteti Kontraktues ka vendosur qe te na eliminoj ende pa u perfunduar afati ligjor prej 5 dite per dergimin dhe plotesimin e dokumenteve te kerkuara .

Pra, ekzistenca e një detyrimi tatimor nuk mund të trajtohet automatikisht si një rrethanë që sjell eliminimin e operatorit ekonomik, pa u analizua

Veçanërisht, Autoriteti Kontraktues nuk mund të kufizohet vetëm në konstatimin se marrëveshja e fundit me ATK-në është lidhur më 27.03.2026, pa marrë parasysh dokumentacionin tjetër dhe rrethanat faktike që dëshmojnë marrëdhënien tonë me ATK-në. Per kete eshte dashur te kerkoj sqarime nga Operatori ekonomik.

Megjithatë, nga arsyetimi i vendimit të AK-së rezulton një trajtim i ndryshëm dhe jo i njëtrajtshëm i dokumentacionit të dy anëtarëve të të njëjtit Grup Ekonomik.

Për njërin nga anëtarët e Grupit Ekonomik, Autoriteti Kontraktues e ka konsideruar të rregullt dhe të pranueshëm vërtetimin tatimor të lëshuar nga ATK-ja më datë **12.08.2026**, duke mos e kërkuar para datës së Njoftimit për Kontratë.

Ndërkohë, për anëtarin tjetër, përkatësisht **liderin e Grupit të Operatorëve Ekonomikë**, Autoriteti Kontraktues ka vendosur një standard krejtësisht tjetër, duke kërkuar gjendjen tatimore para njoftimit për kontratë. Kjo mënyrë e veprimit të Autoritetit Kontraktues

është e paqartë, e pabarabartë dhe kërkon një arsyetim konkret ligjor, pasi nuk është e qartë se mbi çfarë dispozite të LPP-së, Rregullores apo Dokumentacionit të Tenderit AK ka vendosur kritere të ndryshme për dy anëtarë të të njëjtit Grup Ekonomik.

Nëse vërtetimi tatimor i datës **12.08.2026** është konsideruar i mjaftueshëm për njërin anëtar të Grupit, atëherë duhet të sqarohet se përse për anëtarin tjetër nuk është konsideruar i mjaftueshëm vërtetimi përkatës i ATK-së .

Autoriteti Kontraktues ka qenë i obliguar që dokumentacionin e të gjithë anëtarëve të Grupit ta vlerësojë mbi bazën e **të njëjtit kriter, të njëjtit standard dhe të njëjtës dispozitë ligjore**, në mënyrë objektive dhe të barabart.

III. SHKELJA E PARIMIT TË TRANSPARENCËS, BARAZISË DHE TRAJTIMIT TË BARABARTË

LPP-ja kërkon që Autoriteti Kontraktues gjatë zhvillimit të procedurës të respektojë parimet themelore të prokurimit publik, përfshirë trajtimin e barabartë dhe jo-diskriminues të operatorëve ekonomikë, transparencën dhe objektivitetin në vendimmarrje.

Autoriteti Kontraktues, pasi ka eliminuar Grupin tonë Ekonomik, ka shpallur fitues **të njëjtin Grup Ekonomik nese ish shqyrtuar do duhej te elimnohej nga gara.**

Përndryshe, krijohet një situatë e pabarabartë në të cilën një operator ekonomik eliminohet për një interpretim të caktuar të kushteve të përshtatshmërisë, ndërsa një operator tjetër, për të cilin ekziston një vendim i mëparshëm i OShP-së, trajtohet ndryshe.

Kjo bie ndesh me parimet e barazisë, transparencës dhe trajtimit të barabartë të operatorëve ekonomikë.

LPP-ja kërkon që Autoriteti Kontraktues, gjatë zhvillimit të procedurës së prokurimit, të respektojë parimet themelore të prokurimit publik, përfshirë trajtimin e barabartë dhe jo-diskriminues të operatorëve ekonomikë, transparencën dhe objektivitetin në vendimmarrje.

Në rastin konkret, pas eliminimit të GOE-së sonë, Autoriteti Kontraktues ka rekomanduar për dhënie të kontratës një grup tjetër ekonomik. Kundër përgjegjshmërisë së këtij grupi, ne kemi paraqitur në mënyrë konkrete pretendime, fakte dhe prova, të cilat sipas vlerësimit tonë dëshmojnë se GOE-ja e rekomanduar nuk i përmbush kërkesat e përcaktuara në Dosjen e Tenderit dhe në LPP.

Megjithatë, AK, në përgjigjen e tij, nuk i ka shqyrtuar në mënyrë substanciale këto pretendime dhe prova, por është kufizuar në arsyetime të përgjithshme, pa dhënë një vlerësim konkret për secilën nga çështjet e ngritura nga ana jonë.

Kjo është veçanërisht problematike duke pasur parasysh se edhe **ekspertja në raportin e saj ka rekomanduar që dokumentet dhe faktet e paraqitura nga ana jonë të verifikohen nga Autoriteti Kontraktues.**

V. SHPALLJA E FITUESIT PARA SKADIMIT TË AFATIT LIGJOR

Një shkelje tjetër procedurale, të cilën e kundërshtojmë në mënyrë të veçantë, është fakti se Autoriteti Kontraktues ka shpallur operatorin tjetër ekonomik fitues **pa përfunduar afati prej pesë (5) ditësh** që na ishte dhënë për dorëzimin e dokumentacionit të kërkuar.

Ne kemi qenë të njoftuar nga Autoriteti Kontraktues për dorëzimin e dokumenteve dhe kemi pasur afatin e përcaktuar prej pesë (5) ditësh.

Përderisa ky afat nuk kishte përfunduar, Autoriteti Kontraktues nuk ka mundur në mënyrë të ligjshme të përfundonte procedurën duke shpallur një operator tjetër fitues, duke e konsideruar paraprakisht Grupin tonë si të eliminuar.

Veprimi i tillë cenon të drejtën tonë për të përmbushur kërkesën e AK-së brenda afatit të përcaktuar dhe cenon vetë rregullsinë e procedurës së prokurimit.

Ne kemi qenë duke pritur pergjigjen që do jepke Krpp lidhur me marrveshjen e ATK dhe Brenda afatit ligjor të dergojmë te Autoriteti Kontraktues edhe vertetimet tatimore para njoftimit për kontratë por kjo na është pamundesuar pasi AK ka bërë njoftimin për kontratë Brenda afatit ligjor dhe jemi eliminuar duke shkelur dispozitat ligjore në fuqi

Bazuar në të gjitha faktet dhe argumentet e paraqitura më lart, konsiderojmë se vendimi i Autoritetit Kontraktues për eliminimin e Grupit tonë Ekonomik është i kundërligjshëm dhe i pabazuar.

Dokumentet e kërkuara nga AK janë dorëzuar më 21.08.2026, pra brenda afatit të përcaktuar. Megjithatë, AK në mënyrë të gabuar e barazon dorëzimin e dokumentacionit brenda afatit me përfundimin e mundësisë së operatorit për të paraqitur dëshmi plotësuese, pa treguar ndonjë dispozitë konkrete të LPP-së apo të Dosjes së Tenderit e cila përcakton se dokumentet duhet të dorëzohen vetëm në një parashtrim dhe se çdo dëshmi plotësuese brenda afatit nuk mund të merret në konsideratë.

Thelbi i çështjes nuk qëndron në faktin nëse AK ka pasur të drejtë t'i shqyrtojë dokumentet para përfundimit të afatit, por në faktin nëse **AK ka bërë një vlerësim të plotë dhe objektiv të të gjithë dokumentacionit zyrtar të ATK-së dhe nëse nga ky dokumentacion realisht rezulton se GOE nuk e ka përmbushur kërkesën e pranueshmërisë sipas nenit 65 të LPP-së.**

AK pretendon se dokumentet e dorëzuara pas nxjerrjes së vendimit nuk e ndryshojnë bazën e eliminimit. Mirëpo, kjo nuk mund të përdoret si arsyetim për të shmangur shqyrtimin e provave të paraqitura nga operatori ekonomik, veçanërisht nëse ato kanë rëndësi për përcaktimin e gjendjes reale tatimore. Autoriteti Kontraktues ka për detyrë të vlerësojë gjendjen faktike në mënyrë objektive dhe të arsyetojë qartë pse një dokument zyrtar i ATK-së pranohet ose refuzohet si dëshmi.

Prandaj, në bazë të dispozitave të LPP-së për procedurën e rishqyrtimit dhe shqyrtimit të ankesave, kërkojmë nga Autoriteti Kontraktues që:

PËRFUNDIM

Duke marrë parasysh se procedura është zhvilluar nën mbikëqyrjen dhe pas vendimmarrjes së OShP-së, Autoriteti Kontraktues kishte për detyrë që të vepronte në mënyrë strikt të harmonizuar me vendimin/urdhëresën e OShP-së dhe me dispozitat e LPP-së.

Eliminimi i Grupit tonë Ekonomik mbi bazën e një interpretimi formal të datës së marrëveshjes me ATK-në, pa u analizuar statusi real i detyrimit dhe rrethanat e plota faktike, nuk përbën bazë të mjaftueshme për eliminim.

Për më tepër, shpallja e një operatori tjetër ekonomik fitues para përfundimit të afatit të përcaktuar prej pesë (5) ditësh, si dhe shpallja e një grupi ekonomik me cmim me te larte , përbëjnë rrethana serioze që vënë në dyshim ligjshmërinë dhe rregullsinë e veprimeve të Autoritetit Kontraktues.

Për këto arsye, kërkojmë që OShP ta **APROVOJË** Ankesën tone , ta **ANULOJË** vendimin për eliminimin e Grupit tonë Ekonomik dhe vendimin pasues për shpalljen e operatorit tjetër fitues, si dhe ta vazhdojë procedurën në përputhje të plotë me vendimin/urdhëresën e OShP-së dhe legjislacionin në fuqi.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Të Konsiderueshme

10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit."*
- b) një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".*
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,*
- e) bashkëngjit një kopje të vendimit të miratuar nga AK gjatë kontekstit paraprak të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve në përputhje me nenin 108A të LPP-se,*
- f) Dëshminë e pagesës së tarifës së ankimit në përputhje me nenin 118 të LPP-se, dhe*

g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.

***Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.